REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana | 13-03-2013 | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01-013/2013 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.pika 12.2 shkronja d)të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 36.pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë më 11.03.2013 bie këtë:

# V E N D I M

## REKOMANDIM KRYETARIT TË KOMUNËS PËR ANULIMIN E KONKURSIT PUBLIK PËR NDARJËN E BANESAVE PËR PROGRAME TË VEQANTA BANIMI

**I.**

Me këtë Vendim të Kuvendit të Komunës së Vitisë i bahët rekomandim Kryetarit të Komunës së Vitisë që të anulojë Konkursi publik nr.02-111/1391,të datës 03.11.2012 për ndarjën e banesave për programe të veçanta të banimit.

**II.**

Nga Komisioni për vlersimin dhe përzgjedhjën e familjeve për ndarjën e banesave për raste dhe përkujdesje sociale është shpallur Konkursi mbi ndarjën e banesave për rastet sociale në Komunën e Vitisë më 03.11.2012,dhe në të njëjtin Kunkurs nuk është parapar Udhzimi nr.15/2012 për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për invalidët dhe veteranët e UCK-së,që parashifet me Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit nr.03/L-164,andaj në bazën e Vendimit të Kuvendit komunal të datës 11.03.2013,i rekomandojm Kryetarit të Komunës që të anuloj konkursin e shpallur nr.02-111/1391,të datës 03.11.2012,dhe të shpallët konkurs i ri në të cilin duhët të parashihet edhe Udhzimi 15/2012.

**III.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Komunës së Vitisë.

**Vendimi u dorëzohët:**
1. **Zyrës së Kryetarit;**
2. **Kryesuesit të Kuvendit;**
3. **Arkivit.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**/ Skenderbe Hebibi /**

REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA VITI · OPŠTINA VITINA · KUVENDI · SKUPŠTINA